



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:121334

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05278007

Ac.nr.8569/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Arsim Hamzaj, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit/propozuesit së masës së sigurimit F. G. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Basri Jupolli, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës/kundërshtares së sigurimit A. Gj. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Isa Salih avokat nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të pronësisë, caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit të masës së sigurisë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 3196/2023, të datës 17.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 01.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit/propozuesit së masës së sigurimit F. G. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 3196/2023, të datës 17.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr. 3196/2023, të datës 17.11.2023, ka vendosur: REFUZOHET NË TËRËSI SI I PABAZUAR propozimi i paditësit/propozuesit të sigurimit F. G. nga Prishtina, me të cilin ka kërkuar që “Të caktohet masa e sigurimit kundër kundërshtares së sigurimit A. Gj. nga Prishtina dhe t’i ndalohet kundërshtares së masës së sigurimit tjetërsimi, shitja, ngarkimi me çfarëdo barre reale si dhe ndryshimi i gjendjes faktike në paluajtshmërinë – ngastrën me numër 05226-4 me sipërfaqe të përgjithshme 334 m<sup>2</sup>, që gjendet në rrugën “Ismajl Dumoshi” 48B në Prishtinë, deri në vendosjen meritore nga ana e gjykatës në lidhje me padinë. Masa e sigurimit do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike kontestimore”.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Procedurës Kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e propozuesit në tërësi si e bazuar, të prishet aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në ri gjykim dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kundërpropozuesi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit/ve 194, 208 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

*-Ankesa e propozuesit të masës së sigurimit është e pathemeltë*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesi i masës së sigurimit F. G. nga Prishtina, me datën 30.05.2023, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar padi për vërtetim pronësie, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit A. Gj. nga Prishtina, me të cilin ka kërkuar që të aprovohet masa e sigurimit në tërësi si e bazuar, konkretisht si në propozimin e deponuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, ka mbajtur seancën dëgjimore, pas deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktvendim e atakuar C.nr. 3196/2023, të datës 17.11.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: Me nenin 297, par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (tani e tutje referuar si LPK), është paraparë se *masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.* Pra, plotësimi i kushteve është kumulativ, dhe atë: besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë, vështirësohet dukshëm ose pamundësohet realizimi i kërkesës. Ndërsa me nenin 304, par. 3 të LPK-së është paraparë se: *“(…) në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim.”*

Më tej ka thekuar se: Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurimit është i pabazuar nga fakti se propozuesi i sigurimit, për aq sa i përket propozimit për caktimin e masës së sigurisë, nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive të tij, në lidhje me të drejtën eventuale të pronësisë mbi paluajtshmerinë lëndore, në raport me kundërshtarin e sigurimit. Kështu, gjykata vlerëson se propozuesi i sigurimit, përveç se i referohet vazhdimisht raportit juridik të shitblerjes që pretendon ta ketë me kundërshtarin e sigurimit, propozuesi në asnjë rrethanë nuk ka paraqitur apo

argumentuar ekzistimin e raportit të tillë me kundërshtaren e sigurimit, nga ku do të buronte e drejta e tij subjektive.

Më tej ka theksuar se: Gjithashtu, se propozuesi, tani për tani, nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e tij subjektive, rezultoi edhe nga vet deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, e që në asnjë rast a rrethanë nuk doli që ndërgjyqësit kishin një raport juridik kontraktual të ligjshëm, lidhur me shitblerjen e paluajtshmërisë kontestuese. Madje, propozuesi, edhe në vet deklaratimet e tij sa i përket argumentimit të së drejtës së tij subjektive, bazohet në një marrëveshje të qirasë të lidhur ndërmjet propozuesit si qiramarrës dhe L. Gj. si qiradhënës për pronën kontestuese që evidentohet në emrin e kundërshtares së sigurimit. Gjithashtu, sipas deklaratimit të vet propozuesit, propozuesi me kundërshtaren e sigurimit nuk ka nënshkruar asnjëherë kontratë. Në këtë kuptim, në mungesë të konstatimit të së drejtës subjektive të propozuesit të sigurimit, gjykata nuk shqyrtoi a analizoi plotësimin e kushtit të dytë ligjor – atë të rrezikut se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit - ngase kushti i tillë shqyrtohet e vlerësohet vetëm pas plotësimit të kushtit të parë ligjor.

Më tej ka theksuar se: Gjykata konsideron se, në procedurë gjyqësore për caktimin e një mase të sigurimit, është detyrim i propozuesit që të jetë aktiv sa i përket përmbushjes dhe dëshmimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për caktimin e një mase të tillë, detyrim ky që rrjedh edhe nga neni 319 i LPK-së. Në këtë fazë të procedurës, gjykata nuk e gjeti të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë sipas propozimit të propozuesit. Megjithatë, kjo nuk e paragjykon as vendosjen meritorë sipas padisë së tij, e asnjë një vendim tjetër eventual të gjykatës sa i përket sigurimit të kërkesës së tij në fazat e mëvonshme të procedurës, në bazë të rrethanave tjera eventuale të ndryshuara apo të konstatuara ndryshe.

Gjykata e shkallës së parë, për mënyrën e vendosjes është mbështetur në nenin 297 par.1 pika b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilët pretendon propozuesi i masës së sigurimit, si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, sipas dispozitës së nenit 297 par.1, pika a), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore ndër të tjera thuhet se: “...masa e sigurimit mund të caktohet në rast se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive...”, ndërsa në pikën b), ndër të tjera thuhet se: “... duhet të vërtetohet se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar pala kundërshtare do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë.

Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të cekura me lartë për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se paditësi – propozuesi i masës së sigurimit nuk e kanë bërë në masë të mjaftueshme të besueshme të drejtën subjektive të tij, pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova që kishin me vërtetuar një të drejtë të tillë në raport me të paditurit, kjo për faktin se nga provat që gjinden në shkresat e lëndës tani për tani nuk mund të vërtetohet qëllimin i lidhjes së ndonjë raporti juridik në mes të paditësit – propozuesit të masës së sigurisë dhe të paditurës, kundërshtares së sigurimit në lidhje me paluajtshmërinë kontestuese, pasi që të njëjtat prova vërtetojnë krijimin e një raporti tjetër në mes të propozuesit dhe djalit të kundërpropozueses për qiranë dhe fakti ki krijimit të këtij raporti nuk nënkupton se i njëjti me të njëjtat prova mund të vërtetohet edhe të drejtën subjektive në raport me paluajtshmërinë kontestuese për vërtetim të pronësisë..

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit, pasi që e njëjta kishte një vërtetim real të çështjes e duke pas parasysh se propozuesi i sigurimit nuk e ka argumentuar të drejtën subjektive të tij në raport me kërkesën e tij e gjithashtu assesi nuk është bërë i besueshëm rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, për shkak të mundësisë së bartjes apo transferimit të parcelës kontestuese. Andaj, në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit ka dështuar të paraqes prova përmes të cilëve do të plotësoheshim dy kushtet ligjore të parapara nga nenin 297 par.1, pika a), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe si rrjedhojë dhe ankesa e paditëses është refuzuar si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të mere një vendim ndryshe. Kjo për faktin se në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë, për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të lartë cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 209 pika a) dh b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.8569/2023 datë 01.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v